



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetjen të nenit 7 paragrafit 1.24 dhe nenit 33 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 23 qershor 2022,

Miraton:

RREGULLORE NR. 05/2022

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 07/2017 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ASAMBLESË SË KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funksonimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

Neni 2

1. Neni 3 paragrafi 1 i Rregullores bazë, pas togfjalëshit “Kryetari i Gjykatës së Apelit” shtohet togfjalëshi “Kryetari i Gjykatës Komerciale”.

Neni 3

1. Titulli i nenit 4 të Rregullores bazë, plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

Konstituimi i Asamblesë, zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit

2. Në nenin 4 të rregullores bazë, pas paragrafit 3 shtohet edhe dy (2) paragraf të rinj, si në vijim:

4. Asambleja zgjedh Zëvendës Kryesuesin nga anëtarët e saj, me votim të fshehtë, me procedurë të njëjtë si të zgjedhjes së Kryesuesit.

5. Zëvendës Kryesuesi i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Asamblesë ne mungesë te kryesuesit;

3. Në nenin 4 të rregullores bazë paragrafi 4, pas fjalës “**Kryesuesit**” shtohet fjala “**dhe Zëvendës Kryesuesit**”

4. Pas përfshirjes së paragrafëve të ri sipas paragrafit 2 të kësaj rregullore, ndryshohet renditja e paragrafëve në rregulloren bazë, ashtu që ri listohet radhitja numerike e paragrafëve të tjera në këtë nen.

Neni 4

1. Neni 5 paragrafi 1 i Rregullores bazë, plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:



1. Takimi i Asamblesë mbahet me ftesë te Kryesuesit të Asamblesë së paku katër (4) herë në vit, çdo tre (3) muaj nga një mbledhje.

2. Neni 5 paragrafi 2 i Rregullores bazë, riformulohet si në vijim:

Kryesuesi i Asamblesë i dërgon njoftimin anëtarëve të asamblesë jo më vonë se 15 ditë, përpara takimit. Ftesa duhet të përmbajë vendin dhe datën e takimit, propozimin për rendin e ditës dhe thirrjen për anëtarët që të propozojnë pika shtesë të rendit të ditës. Rendi i ditës përfundimtar, duke i përfshirë të gjitha pikat e propozuara të rendit të ditës së bashku me materialin iu dërgohet anëtarëve të Asamblesë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit në gjuhët zyrtare, së paku dyzetetë (48) orë para takimit.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

 Albert Zogaj,


Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 24.06.2022